

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	---	---

Për:	Grup i Operatorëve Ekonomik: BAZALTI - S SH.P.K.; D & T Group SH.P.K.; N.N.P. EURO CONSTRUCTION; NNT BINI SH.P.K., Dabidol, Shaban Jashari p.n, 21000, Rahovec Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	08.08.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A, paragrafi 10.1 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1 të Rregullores **Nr. 001/2022** për Prokurim Publik, sa i përket **Kërkesës për Rishqyrtim** të datës: **07.08.2023**, të parashtruar nga **Grup i Operatorëve Ekonomik: BAZALTI - S SH.P.K.; D & T Group SH.P.K.; N.N.P. EURO CONSTRUCTION; NNT BINI SH.P.K.** me adresë në **Rahovec**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI I RRUGËVE LOKALE - LOT I – Ritenderim**, me Numër të prokurimit: **623-23-5386-5-1-1**, Numër i brendshëm: **623-23-027-5-1-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **HEDHET POSHTË** si e pa bazuar Kërkesa për rishqyrtim e parashtruar nga **Grup i Operatorëve Ekonomik: BAZALTI - S SH.P.K.; D & T Group SH.P.K.; N.N.P. EURO CONSTRUCTION; NNT BINI SH.P.K.** me adresë në **Rahovec**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI I RRUGËVE LOKALE - LOT I – Ritenderim**, me Numër të prokurimit: **623-23-5386-5-1-1**, Numër i brendshëm: **623-23-027-5-1-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK-së, të datës: **02.08.2023**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me me hapat e mëtejshëm për këtë aktivitetin e prokurimit
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

ARSYETIM

Grup i Operatorëve Ekonomik: BAZALTI - S SH.P.K.; D & T Group SH.P.K.; N.N.P. EURO CONSTRUCTION; NNT BINI SH.P.K. me adresë në **Rahovec**, me datë: **07.08.2023** si palë e pakënaqur ka deponuar Kërkesë për Rishqyrtim pran AK Komuna e Rahovecit, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI I RRUGËVE LOKALE - LOT I – Ritenderim**, me Numër të prokurimit: **623-23-5386-5-1-1**, Numër i brendshëm: **623-23-027-5-1-1**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ - Komuna e Rahovecit, kundër Njoftimit mbi Vendim të AK-së të publikuar me **02.08.2023** në linkun <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

BAZA LIGJORE PËR REFUZIM TË KËRKESËS

Përgjigjja e AK ndaj Pretendimit Ankimor:

Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj ankimor nuk qëndron dhe është i pabazuar, pasi që vlerësimi i ofertave është bërë konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, ju ka Njoftuar juve si Operator Ekonomik ankues, sipas formularit **B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar**, ku nuk e keni plotësuar këto kriter sipas Njoftimit për Kontrate/Dosjes se tenderit:

B42 Letër standarde për tenderuesin e eliminuar:

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

Ju njoftoj se ju si O.E. nuk i keni plotësuar kërkesat minimale sipas Dosjes së tenderit tek Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT):

Sqarimet janë si në vijim:

Nuk e plotësoni kërkesën e Sigurimit të tenderit, ju keni dorëzuar sigurimin e tenderit mirëpo jo konform kërkesës dhe rregullave të Udhëzuesit për Prokurimin Publik, dëshmia e sigurimit të tenderit nuk e plotëson kërkesën e Autoritetit Kontraktues, sepse ky dokument nuk përmban kushtet e përcaktuara sipas formës standarde pjese e DT, ku Sigurimi i dorëzuar nga ana juaj, i cili është bërë nga Kompania e Sigurimeve SIGKOS, është i panënshkruar nga Kompania e Sigurimeve:


Nënshkrimi dhe vula e Garantuesve
INSURANCE COMPANY
Emrit Bankës ose i institucionit financiar
Agjent në sigurime
K.S. SIGKOS Sh.a 198
Lagjja Kalabria, Kompleksi Riera, Hyrja Z10, Magjistralja
Prishtinë-Shkup, 10000 Prishtinë, Kosovë
Data
21.06.2023

Në dosjen e tenderit është dhënë forma standarde e Sigurimit të tenderit e cila duhet të dorëzohet në harmoni me kërkesën e AK-së operatorët ekonomik, mirëpo Sigurimi i tenderit që ju keni dorëzuar është në kundërshtim me Nenin 57 të LPP-së dhe Nenin 47.17 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik, pra ky dokument nuk është në pajtueshmëri.

Bazuar në tabelarin e Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ në faqen 90 kemi shembullin se si duhet vepruar:

Shembujt e mëposhtëm nuk janë të vetmet raste. Varësisht nga rasti i paraqitur AK duhet të veproj ne përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-se

Problemi	Si të veprohet?	Neni i LPP-se
Sigurimi i tenderit nuk përmban kushtet e përcaktuara sipas formës standarde pjese e DT	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	57

Kapaciteti teknik dhe professional:

Kërkesa 2: Operatori Ekonomik duhet te ketë ne listën te paktën këtë staf profesional

2.3. Inxhinier i diplomuar i Gjeodezisë ose Master – me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit;

Dëshmia 2:

• Diplomati përkatëse – Kopje të noterizuar;

Sqarimet janë si në vijim:

Në ofertën e juaj të dorëzuar, për pozitën Inxhinier i diplomuar i Gjeodezisë ose Master, me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit, keni prezantuar z. **Ibrahim Ajeti**, nga dëshmitë e kërkuar dokumentare është kërkuar: *Inxhinier i diplomuar i Gjeodezisë ose Master – me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit;*

Inxhinieri ne fjale me diplomën e prezantuar me Nr. MP-673, është specifikuar se studimet i mbaroi me datë: 22.07.2019, ndërsa diploma është lëshuar me datë: 09.09.2019, dhe nuk ka përmbush kërkesën me përvojën e punës e cila është kërkuar, min. 5 vite përvojë pune pas diplomimit, andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Astrit Mullabazi
Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Komuna e Rahovecit